



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 777/ Prot.

Tiranë, më 21.05.2021

Lënda: Dërgohet Vendimi Nr. 81, datë 21.05.2021, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.


Z. SPARTAK NGJELA

Studio Ligjore "Law Firm & Finance", Rruga: "Donika Kastrioti", Nr. 14
Tiranë

Për dijëni: Qendra T'REJA
Rruga: "Vangjel Capo", Pall. 2, Shk. 2, Ap. 26
Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin Nr. 81, datë 21.05.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 777 Prot.

Tiranë, më 21.05.2021

V E N D I M

Nr. 81, Datë 21.05.2021

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

K O N S T A T O N:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat “a” dhe “c”, dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 152, datë 15.12.2020, të paraqitur nga Qendra “T’REJA” kundër z. Spartak Ngjela, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të etnisë², të komunitetit Rom.

Bazuar në nenin 33/10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 58, datë 12.04.2021, me anë të të cilit ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit Rom nga ana e z. Spartak Ngjela, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes”. Në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur që: “Z. Spartak Ngjela, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë, e cila paragjykon haptazi dhe prek dinjitetin e personave të komunitetit rom”, si masë konkrete për të përmirësuar situatën diskriminuese.

¹ Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

² Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka adoptuar një qasje të gjerë duke e përkufizuar “diskriminimin racor” se përfshin “racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, shtetësinë, origjinën kombëtare apo etnike”, (ECRI, General Policy Recommendation Nr. 7 on National Legislation to Combat Racism and Racial Discrimination, CRI(2003)8, adopted 13 December 2002, par 1(b).

Me shkresën datë 06.05.2021, të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 730, datë 07.05.2021, z.Ngjela, ka kthyer përgjigje Komisionerit, duke deklaruar në mes të tjerash se: “Çështjen e pjesëmarrjes së fëmijëve romë në revoltën e muajit Dhjetor 2020, për shkak të vrasjes së shtetasit Klodian Rasha, e ka dhënë shtypi mbarë shqiptar dhe media elektronike. Në funksion të këtij fakti, deklaron: Unë kam përsëritur vetëm ato që ka dhënë shtypi dhe asgjë më shumë. Çfarë falje duhet të kërkoj?”.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se z. Spartak Ngjela është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pasi nuk ka zbatuar Vendimin nr. 58, datë 12.04.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32/1, germa “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/a dhe 14, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Z. Spartak Ngjela, të gjobitet në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit, brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i Vendimit nr. 58, datë 12.04.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

